



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 24/3 Prot.

Tiranë, më 15/01 /2019

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 2 , datë 15/01/2019

“PËR

**MIRATIMIN E EFEKTIT FINANCIAR TË ZBATIMIT TË VKM-ve TË PAKETËS
STUDENTORE PËR UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS SI DHE
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË CILËT
PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE LISTËN E
STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË CILËT PËRFITOJNË NGA REDUKTIMI
I TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50 %**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimin në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar me VKM-në nr. 698, datë 21.11.2018, nr. 779, datë 26.12.2018; VKM nr. 778, datë 26.12.2018 Për një ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve , në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë “, të ndryshuar; VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programme të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”; VKM-së nr. 784, datë 26.12.2018 Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fodi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë efektin financiar të parashikuar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2019, sipas pasqyrës nr.1 bashkëlidhur.

2. Të miratojë listën e studentëve të ciklit të parë të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit si dhe listën e studentëve të ciklit të dytë të cilët përfitojnë nga reduktimi i tarifës vjetore të shkollimit në masën 50 %, sipas listave bashkëlidhur.
3. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2019, sipas pasqyrës nr.1 bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Gerti JANAQI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Albana KOÇIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Plarent NDRECA

